

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alinea 9 dhe nenin 20 paragrafi 1 alinea 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi 1 alinea 8 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, në lidhje me nenin 90 paragrafi 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 294/21), Rregulloren për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.122/20) dhe Rregulloren për përmbytjen dhe formën e aktit për mënyrën e kryerjes së video-mbikëqyrjes („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.122/20 dhe 280/21), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-2312/5 datë 14.06.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 23-të mbajtur më 14.06.2022, miratoi:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLAVE TË PROCEDURËS PËR
MËNYRËN E KRYERJES SË VIDEO-MBIKËQYRJES NË OBJEKTIN PALLATI
„PANKO BRASHNAROV“ NGA ANA E AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin Pallati „Panko Brashnarov“ nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.01-3789/1 datë 27.07.2016, preambula ndryshon dhe thotë:

„Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alinea 9 dhe neni 20 paragrafi 1 alinea 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi 1 alinea 8 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me nenin 90 paragrafi 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 294/21), Rregulloren për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.122/20) dhe Rregulloren për përmbytjen dhe formën e aktit për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.122/20 dhe 280/21), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-2312/5 të 14.06.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 23-të mbajtur më datë 14.06.2022, miratoi:“

Neni 2

Titulli i Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin Pallati „Panko Brashnarov“ nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndryshon dhe thuhet: „Rregullore për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin ku ndodhet selia e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale“.

Член 3

Titulli i kreut „I.Dispozitat e përgjithshme“ dhe neni 1 ndryshohen dhe thuhet:

„I.Dispozita themelore

Neni 1

Në këtë Rregullore përshkruhet mënyra e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin ku ndodhet selia e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (në tekstin në vijim: ASHMA) në cilësinë e Kontrollorit, qëllimet dhe shtrirja e kryerjes së video mbikëqyrjes, njoftimi për kryerje të video mbikëqyrjes, masat teknike dhe organizative që ASHMA-ja i aplikon për të ofruar siguri dhe mbrojtje të të dhënave personale përmes kryerjes së video mbikëqyrjes, afati dhe mënyra e ruajtjes së shënimeve të video mbikëqyrjes dhe mënyrën e fshirjes së video shënimeve, si dhe mënyrën e bërjes së një kopje rezervë dhe të drejtat dhe detyrimet e personave të autorizuar që kanë hyrje në sistemin për kryerjen e video mbikëqyrjes.“

Neni 4

Në kreun „I.Dispozita të përgjithshme“ (në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet riemërtohet dhe thuhet „I. Dispozita bazë“), shtohen 3 (tre) nene të reja 2, 3 dhe 4 që thonë(deklarojnë):

„Neni 2

Video mbikëqyrja në objektin ku ndodhet selia e ASHMA-së, rr.„Makedonija“ nr.38 Shkup, kryhet nëpërmjet 5 (pesë) video kamerave dixhitale të lidhura me sistemin e regjistrimit (NVR), të cilat janë të vendosura brenda këtij objekti.

Kamerat e instaluar brenda janë vendosur në:

- hyrjen kryesore dhe dytësore të objektit dhe regjistrojnë hapësirën para derve të hyrjes nga ana e brendshme,
- në hapësirat e nëndheshme në katin (-2 dhe -1) dhe regjistrojnë hyrjen dhe daljen nga ashensori për automjetet nga ana e brendshme dhe
- në sallën e serverëve të Agjencisë nga ana e brendshme dhe regjistrojnë hyrje dhe daljen nga salla e serverit nga ana e brendshme.

Kamerat janë aktive 24 orë, dhe kryejnë video regjistrim për detektimin e lëvizjeve. Video regjistrimet që ata i detektojnë, transmetohen nëpërmjet instalimit kabllor deri tek centrali kryesor, i cili ndodhet në sallën e serverit në një vend (dollar) i posaçëm (RACK) ku të drejtën e qasjes dhe përdorimit e ka vetëm administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes dhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

Neni 3

ASHMA-ja emëron administrator të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes i cili është i autorizuar dhe përgjegjës për menazhimin operacional të punës së sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes sipas dispozitave të Rregullores dhe akteve të brendshme të miratuara nga ASHMA-ja.

ASHMA-ja emëron dhe ndihmës administrator të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes me të njëjtat të drejta dhe detyrime si administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

Zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes e zëvendëson administratorin në raste kur mungon ose kur për arsye shëndetësore ose të tjera arsye nuk është në gjendje të kryejë detyrimin ndaj punës lidhur me video mbikëqyrjen.

Administratori dhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes hyjn me fjalëkalime të ndryshme.

Autorizimin për kryerjen e përpunimit të të dhënave personale që përmban sistemi për video mbikëqyrje i këtij neni i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërese e saj (Shtojca nr.1).

Administratori dhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes janë të obliguar për kryerjen përpunimin e regjistrimeve në mënyrë të

ndërgjegjshme dhe profesionale në përputhje me Rregulloren dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Administratori dhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes nënshkruajnë Deklaratë për të garantuar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes. Formulari i deklaratës nga ky nen është dhënë si shtojcë e Rregullores dhe është pjesë përbërëse e saj (Shtojca nr.2).

ASHMA-ja ka të drejtë të ushtrojë kontroll në çdo kohë mbi punën e administratortit dhe/ose zëvendës administratorit të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes në pajtim me këtë Rregullore. Nëse gjatë kontrollit të kryer nga ana e ASHMA-së u konstatua se administratori dhe/ose zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes nuk i përmbahet/en ligjeve ose dispozitave nënligjore, si dhe ndaj dispozitave të Rregullores, për të njëjtin/tët do ti/tu merret autorizimi i dhënë dhe do të vlerësohet gjendja për fillimin e procedurës së duhur për përcaktimin e përgjegjësisë.

Член 4

Shkresat e shkruara në lidhje me sistemin për kryerjen e video mbikëqyrjes ruhen nga administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, dhe në rast të mungesës së tij nga ana e zëvendës administratorit të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, në një regjistër të veçantë i vendosur në hapësirat e zyrës së tij/saj.

Evidenca për hyrjen dhe kontrollin e regjistrimeve mbahen për 5 (pesë) vjet që nga fillimi i saj.

Çelësat e pajisjeve kompjuterike dmth njësisë RACK mbahen të siguruara, dmth të mbyllura në hapësirën e punës së administratortit të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes. Qasje ndaj çelësit ka edhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

Infrastruktura e rrjetit të sistemit mbikëqyrës-video është e pavarur nga rrjete të tjera komunikimi të ASHMA-së. Sistemi video mbikëqyrës është i lidhur me rrjetin elektronik të objektit për të cilin ka furnizim të pandërprerë me energji elektrike (agregat).“

Neni 5

Në kreun „II.Qëllimet e video mbikëqyrjes“, në nenin 2 (në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet neni 5) bëhen ndryshime dhe plotësime si në vijim:

- në paragrafin 1, fjalët: „Pallati „Panko Brashnarov“ fshihen, dhe pas fjalës: „objekti“ shtohen fjalët: „ku është akomoduar selia e ASHMA-së“

- paragrafi 2 ndryshon dhe thuhet: „nevoja për kryerjen e video mbikëqyrjes në objektin ku është akomoduar selia e ASHMA-së është më detajisht e përpunuar në Analiza e qëllimit, dmth qëllimet për cilat/cilin vendoset video mbikëqyrje në ASHMA e cila është pjesë përbërëse e Rregullores,(Shtojca nr.3). Analiza i përmban arsyet për vënie të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes me arsyetim të nevojave për përmbushjen e qëllimit, gjegjësisht qëllimeve në kuptim me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

- pas nenit 2 (i cili në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet neni 5) shtohet neni 6 i cili thotë:

„Neni 6

ASHMA për mbrojtjen e të dhënave personale kryen vlerësim periodik të rezultateve të arritura nga sistemi për kryerjen e video mbikëqyrjes për çdo 2 (dy) vjet Kontroll periodik nga paragrafi 1 i këtij neni i referohet veçanërisht:

- nevojave të mëtejshme për shfrytëzim të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes;

- qëllimi i kryerjes së video mbikëqyrjes;
- zgjidhjet e mundshme teknike për zëvendësim të sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes;
- treguesit statistik për qasjen deri tek video shkresat;
- mënyrën e shfrytëzimit të video shkresave dhe
- kërkesë për qasje në të dhënat personale të përpunuara përmes sistemit për video mbikëqyrje dhe kërkesë për nxjerrjen e regjistrimeve për prezencë fizike në hapësirat e ASHMA-së.

Në bazë të vlerësimeve të bëra nga paragrafi 1 të këtij ligji, administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, ndërsa në mungesë të prezencës së tij zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, përgatit Raport nga vlerësimi periodik i kryer i rrezultateve të arritura nga sistemi për kryerjen e video mbikëqyrjes në ASHMA i cili përmban dhe tregues statistikor për qasjen në regjistrim e marrë gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes dhe mënyrën e përdorimit të tyre, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje (Shtojca nr.4).

Neni 6

Kreu „V.Kategoritë e të dhënave personale“ bëhet kreu III dhe thotë: „III. Kategoritë e subjekteve dhe kategoritë e të dhënave personale që përpunohen“.

Neni 7

Në kreun V (e cila në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet kreu III.), në nenin 5 (e cila në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet neni 7), në paragrafin 1 bëhen ndryshime si në vijim:

- në alinen 1 dhe alinea 2 fjalët: „dhe fiziologjikisht“ fshihen dhe
- në alinen 2 fjalët: „Pallati Panko Brashnarov“ fshihen, dhe pas fjalës: „objekt“ shtohen fjalët: „ku ndodhet selia e ASHMA-së.“

Neni 8

Në kreun „III.Kategoritë e subjekteve dhe kategoritë e të dhënave personale që përpunohen“, pas nenit 7, shtohet neni 8, që thotë:

„Neni 8

ASHMA mund të tërheqë të dhënat personale të mbledhura përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, pra të lejojë inspektim ose ti japë në përdorim ose ti transferojë të dhënat personale tek një person i tretë/palë e tretë, vetëm dhe në mënyrën e përcaktuar me rregulloret e Republikës së Maqedonisë Veriore të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale.“

Neni 9

Pas kreut III.Kategoritë e subjekteve dhe kategoritë e të dhënave personale që përpunohen“, shtohet kreu i ri IV. dhe dy nene të reja 9 dhe 10 që thonë:

„IV.Zbatimi i masave të sigurisë teknike dhe organizative për sigurimin e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes

Neni 9

ASHMA-ja përcakton masa teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, veçanërisht në përputhje me Rregulloren për sigurimin e përpunimit të të dhënave personale, si dhe rregullore të tjera në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale duke dhënë një përshkrim të detajuar të masave teknike dhe organizative të ndërmarra.

Me marrjen e masave teknike dhe organizative duhet të mënjanohen:

- shkatërim i rastësishëm ose i paligjshëm i regjistrimeve;
- përmirësim i paautorizuar, zbulim ose qasje gjatë përpunimit të video shkresave, dhe
- qasje e paautorizuar në mbledhjen e të dhënave nga një vendndodhje tjetër nëpërmjet pajisjeve të komunikimit.

ASHMA ofron masat teknike të mëposhtme për fshehtësinë(konfidencialitetin) dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të video mbikëqyrjes, dhe në veçanti:

1. emër përdorues unik për personin e autorizuar;
2. emër i përdoruesit dhe fjalëkalimi i dhënë personit të autorizuar i mundësojnë qasje në sistemin për kryerjen e video mbikëqyrjes, nga ku fjalëkalimi është i përbërë nga kombinimi i të paktën tetë shkronjave alfanumerike (shkronja të mëdha dhe të vogla), simbole, numra dhe shenja të pikësimit (interpukciski);
3. dalja automatike nga sistemi për kryerjen e video mbikëqyrjes pas skadimit të një periudhe të caktuar pasiviteti (jo më gjatë se 15 minuta) dhe për riaktivizim të sistemit të kërkuar është e nevojshme të rifutet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi;
4. fjalëkalimet të ndryshohen pas një periudhe kohore nuk mund të jetë më gjatë se tre muaj;
5. refuzim automatik nga sistemi për video mbikëqyrje pas tre përpjekjeve të dështuara për hyrje (duke futur emrin e gabuar të përdoruesit ose fjalëkalim) dhe njoftim i automatizuar personit të autorizuar se duhet të kërkohet udhëzim nga administratori ose zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes;
6. masa mbrojtëse kundër përpjekjeve të panevojshme ose të qëllimshme për hyrje ose depërtim në sistem;
7. lidhjen e sistemit të video mbikëqyrjes me rrjetin energjistik nëpërmjet pajisjeve(njësi) për furnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Neni 10

Njësia informtive përgjegjëse për burimet njerëzore e informon administratorin dhe zëvendës administratorin e sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, për punësimin ose angazhimin e personit të autorizuar me të drejtën për hyrjen në sistem për kryerjen e video mbikëqyrjes, për t'i caktuar një privilegj të caktuar përdoruesit, gjegjësisht emri i përdoruesit dhe fjalëkalimin, si dhe për ndërprejen e punësimeve ose angazhimeve, për të fshirë emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, dmth i kyçur për akses të mëtejshëm.

Njoftim nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet dhe për ndryshime të tjera në statusin e punës ose në statusin për angazhimin në punë të administratorit dhe/ose të zëvendës administratorit në sistemin për kryerjen e mbikëqyrjes administrative e cila ka ndikim ndaj nivelit të aksesit të lejuar në sistemin e video mbikëqyrjes."

Neni 10

Pas kreut „IV.Zbatimi i masave teknike dhe organizative për sigurimin e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes“, shtohet kreu V. dhe tre nene të reja 11, 12 dhe 13 që thonë:

„V.Dhënien e të dhënave personale për përdoruesit dhe shkëmbimi i të dhënave personale të përpunuara përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes

Neni 11

Administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, në rast të mungesës së tij zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e përpunimit të të dhënave

personale përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes. Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni në veçanti përmban të dhëna si në vijim:

- emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar;
- data dhe ora e hyrjes;
- qëllimin e hyrjes;
- data dhe koha e inçizimit të kryer ndaj së cilës kryhet hyrja;
- data dhe koha, emri dhe selia e përdoruesit të cilit i është dhënë inçizimi nga video mbikëqyrja;
- lloji i medias në të cilën përfshihet regjistrimi nga video mbikëqyrja dhe
- të dhëna të tjera në pajtim me dispozitat e Rregullores për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 12

Të dhënat personale që përpunohen përmes sistemit për video mbikëqyrje mund t'i jepen në përdorim përdoruesit në raste të caktuara kur zbatohen bazuar në kërkesën me shkrim të përdoruesit, përderisa ky përdorues në pajtueshmëri me ligjin është i autorizuar për përpunimin e të dhënave personale. Administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, në rast të mungesës së tij zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale mban evidencë mbi Kërkesat për qasje dhe këqyrje në të dhënat personale të përpunuara përmes sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes nga përdoruesi.

Evidenca (Shtojca nr.5 e kësaj Rregulloreje) e cila në pajtueshmëri me bazat e udhëheq administratori i sistemit për video mbikëqyrje, dhe në rast të mungesës së tij zëvendës administratori për kryerjen e video mbikëqyrjes në veçanti përmban të dhënat si në vijim:

- emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar si subjekt për paraqitjen e kërkesës;
- kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që kërkohen;
- data dhe koha e hyrjes;
- baza ligjore, gjegjësisht arsyen e hyrjes;
- datën dhe orën e inçizimit të bërë dhe shkakun e hyrjes, e cila dhe jepet në përdorim ose shkëmbim;
- datën dhe kohën, emri dhe selia e përdoruesit të cilit i është dhënë inçizim nga video mbikëqyrja;
- llojin e medias ku mbahet inçizimi nga video mbikëqyrja, dhe
- të dhëna të tjera në pajtueshmëri me dispozitata e Rregullores për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale, si dhe dispozitave të tjera për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13

Sigurimi fizik i sistemit për video mbikëqyrje është siguruar përmes vendosjes së sistemit për video mbikëqyrje në sallën servere.

Neni 11

Kreu „X.Afati i ruajtjes së inçizimeve,shikimi i materialit të regjistruara“ bëhet kreu VI që thotë: „VI.Afati i ruajtjes së regjistrimeve nga video mbikëqyrja“.

Neni 12

Në kreun X (e cila në pajtueshmëri me ndryshimet dhe plotësimet bëhet kreu VI), nenet 10 dhe 11 hiqen dhe shtohet neni i ri (14) që thotë:

„Neni 14

Inçizimet e bëra nga sistemi për video mbikëqyrje në objekt ruhen si pajisje të specializuara NVR (Network Video Recorder), e cila ndodhet në server sallën të

ASHMA-së në orman të veçantë (RACK), në të mund të hyhet vetëm me çelës për hapjen e ormanit (RACK) dhe nëpërmjet softuerit të instaluar në vetë pajisjen, në të cilën hyrje ka vetëm administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, dhe në rast të mungesës së tij dhe zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes. Ormani (dollapi) (RACK) është i ndarë nga të gjithë sistemet e tjerë dhe ndodhet në sallën server të Agjencisë.

Inçizimet nga video mbikëqyrja mbahen në hard disk në video rekorderin dixhital, ku hyrje ka vetëm administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes, dhe në mungesë të tij zëvendës administratori i sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes.

Inçizimet nga paragrafi 1 i këtij ligji ruhen më së shumti 30 (tridhjetë) ditë, dhe fshihen automatikisht pas skadimit të afatit.

Nëse në inçizimet e bëra gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes, konstatohet se gjatë kësaj periudhe prej (30 ditësh) është evidentuar incident (ngjarje), vetëm atëherë ky inçizim konkret në të cilin është inçizuar ky incident (ngjarje) mund të ruhet dhe më gjatë se 30 ditë, dhe në varësi të procedurës që zhvillohet në përputhje me ligjin.

Neni 13

Kreu „XI. Njoftim për kryerjen e video mbikëqyrjes“ bëhet kreu VII.

Neni 14

Në kreun XI. (e cila në pajtueshmëri me ndryshimet dhe plotësimet bëhet kreu VII.), neni 12 fshihet dhe shtohen dy nene të reja 15 dhe 16 që thonë:

„Neni 15

Për vendosjen e pajisjeve për kryerjen e video mbikëqyrjes, ASHMA-ja në mënyrën e duhur i informon të punësuarit dhe të punësuarit e Agjencisë për Rini dhe Sport, të cilët kryejnë detyrat e punës në objektin ku kryhet video mbikëqyrje, se në hapësira konkrete pune është vendosur video mbikëqyrje, si dhe për qëllimin/et për të cilin është vendosur.

Neni 16

Me qëllim, për të informuar të gjitha subjektet potenciale të prekura, vende qartësisht të dukshme, siç është hyrja kryesore dhe hyrja anësore e objektit, theksohet në njoftimin për kryerjen e video mbikëqyrjes të dhënat që i përmban si në vijim:

- se kryhet mbikëqyrje nga ana e ASHMA-së;
- mënyra se si mund të merren informacione se ku dhe për sa kohë mbahen inçizimet nga video mbikëqyrja;
- të dhëna për oficerin/ët për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe
- informacione të tjera të detyrueshme në pajtueshmëri me ligjin.

Formulari i njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe Deklaratën për privatësi gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes e cila shpjegon llojin e të dhënave personale, që ASHMA-ja i mbledh gjatë një vizite në hapësirat zyrtare, jepen si shtojcë e kësaj Rregulloreje si pjesë përbërëse (Shtojca nr.6 dhe nr.7).“

Neni 15

Pas kreut VII. shtohet kreu i ri VIII. dhe katër nene të reja 17, 18, 19 dhe 20 që thonë:

„VIII. Mënyra dhe procedura për realizimin e të drejtave të subjektit për të dhënat personale

Neni 17

Me qëllim të zbatimit dhe respektimit të vazhdueshëm të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe në drejtim të respektimit të plotë të të drejtave të subjekteve/ qytetarëve që parashihen në rregullativën ligjore, është paraparë

procedurë për paraqitjen e Kërkesës për dhënie pjesë ose fragment nga video mbikëqyrja për prezencë personale në hapësirat e ASHMA-së.

Arsyetim Kërkesë në 2 (dy) ekzemplar me propozim për të marrë fragment të video mbikëqyrjes për prezencë personale në hapësirat e selisë së ASHMA-së paraqitet në formular. Formulari i kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni është dhënë si shtojcë e kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj (Shtojca nr.8).

Kërkesën për të marrë një fragment nga video mbikëqyrja për prezencë personale në hapësirat e ASHMA-së dorëzohet:

- personalisht nga parashtruesi i kërkesës ose tutori, ose
- nëpërmjet një avokati me prokurë të veçantë të lëshuar nga parashtruesi i kërkesës ose tutori i tij.

Përgjigjja e Kërkesës jepet brenda një periudhe jo më të gjatë se 5 (pesë) ditë pune llogaritur nga dita në vijim pas paraqitjes së të njëjtit.

Neni 18

Ndaj Kërkesës, si shtojcë detyrimisht dorëzohet dhe fotografi të personit për të cilin kërkohet fragment nga video mbikëqyrja për prezencë personale në hapësirat e ASHMA-së. Fotografia i kthehet kërkuarit së bashkë me përgjigjen e Kërkesës.

Neni 19

Pas pranimit të Kërkesës nga neni 17 i kësaj Rregulloreje, në selinë e ASHMA-së, i njëjti vërtetohet me vulë pranimi, një kopje i kthehet kërkuarit, dhe më pas përcillet në përgjegjësi dhe veprim të oficerit/ëve për mbrojtje të të dhënave personale.

Pas marrjes së Kërkesës, arkivi e njofton oficerin/ët për mbrojtjen e të dhënave personale kush dhe pas shqyrtimit të kërkesës/ave për fragmentin, i dorëzojnë mendim drejtorit të ASHMA-së, i cili vendos sipas kërkesës. Komunikimi midis oficerit/ëve dhe drejtorit të ASHMA-së dhe personave të tjerë që janë të involvuar në zgjidhjen e kërkesës duhet të bëhet me e-mail për shkak të llogaridhënies në trajtimin dhe ruajtjen e (gjurmëve) gjurmët e komunikimit .

Neni 20

Personi i autorizuar nga neni 3 i kësaj Rregulloreje përgatit përgjigje të kërkesës e cila e arkivuar i dorëzohet kërkuarit. Nëse kërkesa është miratuar aplikanti i kërkesës njoftohet për ta marrë personalisht ose nëpërmjet tutorit (personit të autorizuar) fragmentin e kërkuar që i jepet një mediumi.“

Neni 16

Kreu XII. bëhet kreu IX dhe thotë: „IX.Specifikimet teknike të pajisjes“.

Neni 17

Në kreun XII. (i cili në pajtueshmëri me ndryshimet dhe plotësimet bëhet kreu IX.), neni 13 (i cili në pajtueshmëri me ndryshimet dhe plotësimet bëhet neni 21) ndryshohet dhe thotë:

„Neni 21

Për kryerjen e video mbikëqyrjes në objektin ku gjendet selia e ASHMA-së, shfrytëzohen 5 (pesë) kamera. Kamerat ofrojnë rezolucion të lartë imazhi (1280x720), ata regjistrojnë vetëm në rast të zbulimit të lëvizjes pa mundësi zmadhimi (motion-detected recording) dhe ato janë statike. Kamerat janë të lidhura me një kabëll për lajmërim dhe transmetim të të dhënave, pajisjet për inçizim të rrjetit тп. NVR (Network Video Recorder) të cilët ndodhen në sallën e serverit të ASHMA-së.

Specifikimi teknik i pajisjes së video mbikëqyrjes së objektit ku është selia e ASHMA-së nga paragrafi 1 i këtij neni, është dhënë si shtojcë në këtë Rregullore (Shtojca nr.9), si pjesë përbërëse e saj.“

Neni 18

Kreu XIII. Bëhet kreu X. Dhe thotë: „X.Plan për vendosjen e sistemit për kryerjen e video mbikëqyrjes“.

Neni 19

Në kreun XIII. (e cila në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet kreu X.), në nenin 14 (në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet bëhet neni 22) kryhen ndryshimet si në vijim:

- fjalët: „Pallati Panko Brashnarov“ fshihen, dhe pas fjalës: „objekt“ shtohen fjalët: „ku është vendosur selia e ASHMA-së“ dhe
- fjalët: „(Shtojca nr.7) zëvendësohet me fjalët: „(Shtojca nr.10)“.

Neni 20

Kreu XIV. bëhet kreu XI., ndërsa nenet 15, 16 dhe 17 bëhen nene 23, 24 dhe 25.

Neni 21

Kreu III., kreu IV., kreu VI., kreu VII., kreu VIII. dhe kreu IX. fshihen.

Neni 22

Shtojcat nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6 dhe nr.7 të Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin Pallati „Panko Brashnarov“ nga vetë Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-3789/1 data 27.07.2016 zëvendësohen me 10 (десят) shtojca të reja që janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 23

Në pjesën tjetër të Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin Pallati „Panko Brashnarov“ nga ana e Agjencisë ark.nr.01-3789/1 data 27.07.2016 nuk ndryshon.

Neni 24

Kjo Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin e Pallatit „Panko Brashnarov“ nga vetë Agjencia hyn në fuqi me ditën e miratimit të tij.

Neni 25

Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e kryerjes së video mbikëqyrjes në objektin e Pallatit „Panko Brashnarov“ nga vetë Agjencia do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe do t'i dorëzohet Agjencisë për Rini dhe Sport.

Nr.01-2375/1
14.06.2022
Shkup

Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v